REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2020:021456

Datë: 10.06.2021

Numri i dokumentit: 01872222

C. nr. 69/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, **Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** me gjyqtarin Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.K. nga ……, të cilin me autorizim e përfaqëson Vlora Kadriu, avokate nga Gjilani, kundër të padituës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson Alban Hashani, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti për kompenzimin e shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve të punës, vlera e kontestit prej 1.616.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjygjëse, më datën 08.06.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit F.K. nga ……;

II. DETYROHET e paditura Komuna e Kamenicës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve të punës, për 808 (tetëqind e tetë) ditë pune, t'ia paguajë shumën prej 1.616.00 (njëmijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) euro, dhe atë për periudhën kohore prej datës 18.04.2017, e deri më datën 04.06.2021, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 10.02.2020, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedures kontestimore, dhe atë në shumë të përgjithshme prej 259.00 euro, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit më dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi F.K. nga ……., përmes të autorizuares së tij Vlora Kadriu, avokat nga Gjilani, më datën 10.02.2020, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të padituës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompenzimin e shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve të punës, me vlerë të kontestit prej 1.616.00 euro.

2020:021457

Gjykata, duke u bazuar në dispozitën e nenit 401, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së), nuk e ka konvokuar fare seancën përgaditore por, e ka caktuar drejtëpërdrejt seancën e shqyrtimit kryesor, ngase duke u bazuar në shkresat e lëndës është vlerësuar se kjo çështje juridike kontestimore nuk është e ndërlikuar.

1. ***Pretendimet e palëve ndërgjyqësë***

E autorizuara e paditëses avokatja Vlora Kadriu, në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 08.06.2021, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe ndryshimit të bërë gjatë seancës kryesore dhe i ka propozuar gjykatës që për t'i vërtetuar ditët të kaluara në punë, për periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri më 04.06.2021, për paditësin F.K., t'i administroj provat e bashkangjitura padisë dhe ato të dorëzuara në shqyrtimin kryesor, e njëjta ka shtuar se baza juridike e kërkesëpadisë mbështetet në Kontraten Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më datën 18.04.2017, e që puntorëve të arsimit në bazë të nenit 35, paragrafi 7, të kësaj Kontrate Kolektive, i'u takojnë shpenzimet për ushqim gjatë ditëve në punë në vlerë prej 2 euro, për një ditë pune, ndërsa në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve në punë për vitet 2016 - 2017, 2017 -2018, 2018 - 2019, 2019 – 2020 dhe 2020 - 2021, respektivisht për 808 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 1.616.00 eurove, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 259.00 euro dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104.00 euro, në emër të pagesës së taksës gjyqësore për padi shumën prej 20.00 euro dhe në emër të përfaqësimit në seancën e shqyrtimit kryesor shumën prej 135.00 euro.

I autorizuari i të paditurës, Alban Hashani, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.06.2021, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke e kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar dhe duke shtuar se Kontrata Kolekive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, nuk është e regjistruar, poashtu ka shtuar se të njëjtit nuk janë palë nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit dhe për të njëjtit si Drejtori Komunale e Arsimit, nuk paraqet ndonjë detyrim. Andaj edhe ka konsideruar se nuk kanë legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore, poashtu i ka kontestuar edhe ditët e llogaritura të punës për vitet shkollore të cekura si në vërtetimin me numër 131, të datës 26.12.2019, të lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti", nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, me arsyetimin se nuk përputhen me Udhëzimin Administrativ me nr.10/2017, ndërsa në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar në ligj.

2. ***Provat e administruara në shqyrtimin kryesor***

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjës faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova materiale: kontratën e punës me nr. 24, e datës 05.04.2017, e lidhur në mes të Drejtorisë Komunale të Arsimit, në Komunën e Kamenicës si punëdhënëse dhe F.K. nga ….. si punëmarrës, kontrata e punës, e datës 01.06.2017, e lidhur në mes të Drejtorisë Komunale të Arsimit, në Komunën e Kamenicës si punëdhënëse dhe F.K. nga ……., kontrata e punës me nr. 367, e datës 07.09.2017, e lidhur në mes të Drejtorisë Komunale të Arsimit, në Komunën e Kamenicës si

2020:021457

punëdhënëse dhe F.K. nga ……. si punëmarrës, kontrata e punës me nr. 192/5, e datës 31.08.2018, e lidhur në mes të Drejtorisë Komunale të Arsimit, në Komunën e Kamenicës si punëdhënëse dhe F.K. nga ……, si punëmarrës, vërtetimi me nr. 131, i datës 26.12.2019, i lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti", nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, vërtetimi me nr. 52, i datës 04.06.2021, i lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti", nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, vërtetimi me nr. 97, i datës 13.12.2019, i lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti", nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, kërkesa e paditësit F.K., drejtuar DKA-së, në Kamenicë, me nr.04-446, e datës 08.01.2020.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, konform dispozitës së nenit 8, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për këto arsye:

Për palët ndërgjygjëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka punuar dhe ende është duke punuar te e paditura, por, për të padituren kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit.

Nga kërkesa e paditësit F.K., drejtuar DKA-së, në Kamenicë, me nr.04-446, e datës 08.01.2020, gjykata e vërtetoj faktin se paditësi F.K., paraprakisht i'u është drejtuar të padituës me kërkesë për realizmin e të drejtës së tij për kompenzimin e shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve në punë, por i njëjti nuk ka marrë përgjigje pozitive nga e paditura.

Nga vërtetimi me nr. 97, i datës 13.12.2019, i lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti", nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, gjykata e vërtetoj faktin se paditësi është punëtor ndihmës, në këtëe shkollë, prej vitit 03.04.2017, me përvoj pune 3 vite e 10 muaj.

Nga vërtetimi me nr. 131, i datës 26.12.2019, i lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti", nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, gjykata e vërtetoj faktin se paditësi F.K. ka të kaluara 617 ditë pune, për periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri më 30.12.2019, periudhë kjo aq sa është në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë.

Nga vërtetimi me nr. 52, i dates 04.06.2021, i lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti", nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, gjykata e vërtetoj faktin se paditësi F.K., ka të kaluara 191 ditë pune, për periudhën kohore prej 01.01.2020 e deri më 04.06.2021, periudhë kohore kjo aq sa është në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë.

3. <u>Ndryshimi i padisë</u>

E autorizuara e paditësit avokatja Vlora Kadriu, në fillim të seancës së shqyrtimit kryesor të datës 08.06.2021, meqenëse gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 401 të LPK-së, nuk e ka konvokuar fare seancën përgaditore, e ka ndryshuar kërkesëpadinë, ashtuqë në vend të shumës prej 1.234.00 euro, e ka zmadhuar të njëjtën në shumë prej 1.616.00 euro me arsyetimin se tani e ka siguruar vërtetimin e ri me nr. 52, të datës 04.06.2021, i lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti" nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, për vërtetimin e ditëve në punë të paditësit, ngase në kohën e paraqitjës së padisë nuk ka qenë e mundur të sigurohet ky vërtetim.

Gjykata, pas kësaj i'a ka dhënë të drejtën e deklarimit përfaqësuesit të palës së paditur dhe i njëjti e ka kundërshtuar ndryshimin e padisë së paditësit si të pa bazuar.

lidhur me këtë e duke u bazuar në dispozitën e nenit 258, paragrafi 4, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku përcaktohet se *"Gjykata në rastin e paragrafit 2 të këtij neni e lejon ndryshimin e padisë edhe po që se i padituri e kundërshton ndryshimin në qoftë se plotësohen këto kondita: a) paditësi, pa fajin e tij, nuk ka mundur më parë ta ndryshojë padinë; b) i padituri ka mundësi të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes të ngritur me padinë e ndryshuar pa u shtyrë seanca kryesore",* gjykata ka konstatuar se paditësi nuk ka mundur që vërtetimin e ri me numër 52, të datës 04.06.2021, i lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti", nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, t'a siguroj më herët dhe të njëjtin ta paraqes si provë së bashku me paraqitjen e padisë, e poashtu gjykata ka konsideruar se i autorizuari i të padituës ka pasur mundësi të marrë pjesë në seancën e shqyrtimit kryesor pa pasur nevoj që e njëjta të shtyhet, madje edhe a'i vetë nuk ka kërkuar që seanca gjyqësore të shtyhet, e duke i marrë parasysh të gjitha këto gjykata me aktvendim procedural e ka lejuar ndryshimin e padisë dhe si vlerë të kontestit e ka konsideruar shumën prej 1.616.00 euro.

4. ***<u>Baza juridike</u>***

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit dhe përcaktimit të lartësisë për shujtën ditore në shumë prej 2 euro në ditë, për 808 ditë pune, është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, e nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), me anë të së cilës, mes tjerash, punëdhënësi (në këtë rasë DKA, në Komunën e Kamenicës), obligohet që punëmarrësit t'ia kompenzojë shpenzimet në emër të ushqimit gjatë ditëve në punë.

Bazuar në nenin 35, paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të lartëcekur, ku përcaktohen të drejtat e të punësuarve për kompenzimin për ushqim gjatë punës, e që është paraparë që për një ditë pune të punësuarit t'i kompenzohet me nga 2 euro, në këtë kuptim paditësi rezulton të ketë kaluar 808 ditë pune, për vitet shkollore 2016 – 2017, 2017 – 2018, 2018 – 2019, 2019 – 2020 dhe 2020 - 2021, fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi me numër 131, i datës 26.12.2019, i lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti" nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës dhe vërtetimit me nr. 52, i datës 04.06.2021, i lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti" nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, e që duke i shumëzuar me 2 euro, del të jetë shuma e përgjithshme prej 1.616.00 euro, shumë kjo e vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në dispozitën e nenin 90, paragrafi 6, të Ligjit të Punës me Nr.03/L-212, përcaktohet se*"Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës se sa ato të përcaktuar në këtë ligj*", poashtu konform dispozitës së nenit 245, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve me Nr.04/L-077, ku përcaktohet se*"Kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbatjen e tij",* gjykata mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore të lartëcekura e aprovoj kërkesëpadinë e

2020:021457

paditësit në tërësi si të bazuar dhe e detyroj të padituren që t'a përmbush detyrimin e saj ndaj paditësit, të cekur - përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

5. ***<u>Vlerësimi përfundimtar i gjykatës</u>***

Andaj, duke u bazuar në dispozitën e lartëcekur të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, dispozitave tjera ligjore të lartëcekura si dhe në gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e ka aprovuar si të bazuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të padituren, që paditësit në emër të kompenzimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve në punë, të i'a paguaj shumën e specifikuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasiqë nga provat e administruara është vërtetuar fakti se paditësi F.K. nga ……., për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më 04.06.2021, ka qenë në vendin e punës për 808 ditë, e të cilin fakt gjykata e vërtetoj në bazë të vërtetimit me numër 131, të datës 26.12.2019, të lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti" nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës dhe vërtetimit me nr. 52, të datës 04.06.2021, të lëshuar nga SHFMU "17 Shkurti" nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, e të cilave prova gjykata u'a fali besimin e plotë, ngase janë dokumente publike, të plota dhe të lëshuara nga organi kompetent, respektivisht të lëshuara nga vet e paditura, e rrjedhimisht i mori për bazë me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, ndërsa edhe pse paditësi paraprakisht kishte kërkuar nga e paditura që të njëjtit t'i kompenzohen shpenzimet për ushqim gjatë ditëve në punë, e padituria Drejtoria Komunale e Arsimit, në Komunën e Kamenicës, nuk e ka përmbushur obligimin e saj, siç e ka pasur detyrim sipas Kontratës Kolektive të Arsimit, në Kosovës, të datës 18.04.2017, sa i përket mjeteve buxhetore për kompenzimin e shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve në punë, të specifikuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, fakt ky i vërtetuar nga kërkesa me shkrim e paditësit F.K., ndaj të paditures, me nr.04-446, e datës 08.01.2020.

Ndërsa lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur, se kërkesëpadia e paditësit për kompezimin e ushqimit për ditët në punë, është në tërësi e pa bazuar dhe e njëjta të refuzohet si e tillë, për faktin se paditësi me asnjë provë nuk ka arritur t'a vërtetojë kërkesëpadinë e tij, si dhe pretendimet se Kontrata Kolekive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, nuk është e regjistruar, si dhe faktin se të njëjtit nuk janë palë nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit dhe për të njëjtit si Drejtori Komunale e Arsimit, nuk paraqet ndonjë detyrim, duke konsideruar se nuk kanë legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore, për gjykaten këto pretendime ishin të pa bazuara, për faktin se me nenin 2, të Kontratës Kolektive të lartëcekur, të gjitha Drejtorit Komunale të Arsimit, në Kosovë, janë të obliguara t'a zbatojnë Kontratën Kolektive të lartëcekur dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, poashtu duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 4, pika 1, të kësaj kontrate Kolektive të lartëcekur, paditësi me pozitë të punës punëtor ndihmës (teknik), hynë në kuadër të përfituesve të të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë Kolektive e Arsimit. Andaj, edhe përgjegjësia për kompenzim të shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve në punë është te e paditura, respektivisht të DKA-së, në Kamenicë.

Gjykata në lartësinë e aprovuar për kompenzimin e shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve në punë, paditësit i'a ka njohur të drejtën e kamatës ligjore prej 8%, nga data 10.02.2020, si datë e paraqitjes së paditës e deri në pagesën definitive, dhe atë në bazë të nenit 382, të LMD-së.

6. Shpenzimet e procedurës kontestimore

Gjykata, vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u mbështetuar në nenin 449 dhe 452, paragrafi 1, të LPK-së, dhe e detyrojë të paditurën, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 259.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro, në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë shumën prej 20.00 euro dhe për përfaqësim në seancën kryesore shumë prej 135.00 euro.

Duke u bazuar në të lartëcekurat, si dhe në nenin 143, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C. nr. 69/2020, i datës 08.06.2021

G j y q t a r i

Artan Abazi

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.